



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.478/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Adnan konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Zeqrija Sermaxhaj nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Kamenicë, paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Kamenicë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga Zeqrija Sermaxhaj nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Kamenicë, me shenjen ZL.A.nr.478/2017 e datë 24.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 24.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Zeqrija Sermaxhaj nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Kamenicë me të cilën theksohet se në disa Qendra të Votimit nr. 1001D/01R, 1001D/02R, 1001D/03R, 1001D/04R, 1001D/05R, 1001D/06R, 1001X/01R, 1001X/02R, 1001X/03R, 1001X/04R, 1001X/05R, 1015D/01R, 1015D/02R, 1023D/01R, 1003D/01R, 1004D/01R, 1026D/01R, 1026D/02R, 1026D/03R, 1005D/01R, 1005D/02R, 1002/01R, 1002D/02R, 1002D/03, 1024D/1, 1024D/2, 1024D/3, 1024D/4 ka pasur parregullsi, pasi që ka pasur mos përputhje të votave të 7 delegatëve nga të dhënat e vëzhguesve nga radhët e subjektit tonë politik krahasur me formularët e prezantuar në vendvotime pas procesit të numërimit të votave.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë sepse, pretendimet ankimore që ndërlidhen me rezultatin e votimit duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së ankueses Zeqrija Sermaxhaj , nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.478/2017 më datën 24.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.